Date: 26.02.2022

KONTRATE DHURIMI
(E Kuotave te Kapitalit Te Shoqerise "GOSLING" sh.p.k)

**Dhurues:**

Shoqëria "BB Strategies LTD"
Perfaqesuar nga"
Z. Lorenc Hastopalli
Z. Ibrahim Hastopalli

**Pranues:**

Z. Gentian Baholli

**Te dhena paraprake;**

Shoqeria "GOSLING" sh.p.k, eshte regjistruar si person juridik ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit me Nuis (NIPT) - L82002026D, ne date 02/08/2018, me kapital me vlere 1000 leke dhe ka status "Aktiv".
Dhuruesii eshte zoterues i 1 kuote të cilat perbejne 65 % te kapitalit te kesaj shoqerie.

**NENI 1**
**Objekti;**

1.1 Objekt i kesaj kontrate eshte kalimi nga dhuruesi te pranuesi të 1 kuote e cila eshte 65 % te kapitalit të shoqerise, pa shperblim dhe pa kusht.

1.2 Shoqëria "BB Strategies LTD" ne cilesine e dhuruesit me vullnet te plote dhe te lire per te vepruar, zoterues i 1 (nje) kuote, 65 % te kapitalit ne shoqeri, ka vendosur ti dhuroje Z. Gentian Baholli 1 (nje) kuote, 65 % te kapitalit qe zoteron ne shoqeri.

1.3 Z.Gentian Baholli ne cilesine e pranuesit te pranon 1 (nje) kuote, 65% te kapitalit te shoqerise nga ortaku i shoqerise i lartpermendur, Shoqëria "BB Strategies LTD".

**NENI 2**
**Kalimi i pronësisë;**

2.1 Me nenshkrimin e kesaj kontrate realizohet kalimi i 1 kuote dhe 65 % te pjeseve te kapitalit te shoqerise "GOSLING" sh.p.k., nga dhuruesi te pranuesi.

2.2 Me nenshkrimin e kesaj kontrate pranuesi i dhurimit behet zotërues i 1 kuote dhe 100 % te pjeseve te kapitalit te shoqerise "GOSLING" sh.p.k., duke marre persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe burojne nga ortak i shoqerise "GOSLING" sh.p.k., nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate.

**NENI 3**
**Deklarime te paleve;**

3.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton pranuesin se, pjeset e kapitalit te shoqerise, që i transferohen dhuruesit, pa asnje kusht, jane te lira nga çdo barre apo rendese tjetër, dhe menjehere lirisht të transferueshme te te tretet dhe mbi to nuk ka asnjë të drejte juridike ndaj te tretëve.

3.2 Pranuesi, deklaron se e njeh gjendjen e shoqerise, e pranon transferimin nëpermjet dhurimit ne favor te tij, duke marre pérsipér té drejtat dhe deryrimet që do te burojne nga qenia pronar mbi

REPUBLIKA E SHQIPERISE GOSLING Sh.p.k. NUIS L82002026D Tirane-Albania

kete pjese te kapitalit, te lindura nga momenti i nenshkrimit te kontrates.

**NENI 4**
**Data efektive e kontrates;**

4.1 Kjo kontraté eshtë e parevokueshme, e pakthyeshme, efektive, e detyrueshme per palet dhe trashegimtaret e tyre, qe nga data e nenshkrimit te saj.

**NENI 5**
**Zgjidhja e Kontrates;**

5.1 Asnje nga palet nuk mund të zgjidhe né menyre te njeanshme ketë kontrate.

**NENI 6**
**Trajtimi i kontratës, aktet bashkelidhur;**

6.1 Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje të barazvlefshme, ne gjuhen shqipe.

6.2 Kjo kontrate zevendeson çfaredolloj marrëveshje, kontrate ose çfaredolloj dokumenti tjeter dhe eshtë e vetmja kontrate detyruese per palet ne lidhje me objektin e dhurimit.

**NENI 7**
**Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni;**

7.1 Kjo kontrate ështe hartuar ne baze té legjislacionit shqiptar dhe konkretisht te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

7.2 Té gjitha mosmarreveshjet qé mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj kontrate, nëse vetë palet me ndihme juridike vazhdojne të mos t'i kuptojne e zbatojne, si dhe ne rast se vetë palet nuk gjejne mirekuptim, mosmarreveshjet lihen objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

**NENI 8**
**Palet;**

**Dhuruesi:**
Shoqëria "BB Strategies LTD"
"
Z. Lorenc Hastopalli
Z. Ibrahim Hastopalli

**Pranuesi:**

Gentian Baholli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GOSLING
Sh.p.k.
NUIS L82002026D
Tirane - Albania